



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS – VLADA KOSOVA – GOVERNMENT OF KOSOVO
MINISTRIA E EKONOMISË DHE FINANCAVE – MINISTARSTVO ZA PRIVREDU I FINANSIJE – MINISTRY OF ECONOMY AND FINANCE
ADMINISTRATA TATIMORE E KOSOVËS – PORESKA ADMINISTRACIJA KOSOVA – TAX ADMINISTRATION OF KOSOVO

Njoftim për Tatimpagues

Administrata Tatimore e Kosovës (ATK), njofton të gjithë tatimpaguesit se, që nga data 1 Tetor, do të bëjë ngritjen dhe modernizimin e sistemit kompjuterik. Si rezultat i kësaj, nga kjo datë, për të shkarkuar deklaratat tatimore nga faqja jonë e internetit www.atk-ks.org dhe për të gjitha Deklarimet apo Raportimet e të tjera në ATK, secili tatimpagues do të jetë i obliguar që të shfrytëzojë **VETËM** Numrin Fiskal (NRF).

- **Nëse i'u është caktuar NRF më parë, mirëpo për shkaqe teknike nuk keni pasur mundësi ta përdorni**

Që nga 1 Tetori, duhet të përdorni NRF të dhënë më parë. Nëse keni harruar NRF të dhënë më parë, ATK, ua ka dërguar këtë me letër përmes Postës së Kosovës.

- **Nëse NUK keni aplikuar për Numër Fiskal**

Administrata Tatimore, ua ka caktuar nga një NRF automatikisht, për të cilin jeni njoftuar përmes letrave për secilin tatimpagues individualisht.

- **Nëse jeni pronar i më shumë se një biznesi individual**

Ju, do të jeni të obliguar që t'i bashkoni të ardhurat e të gjitha bizneseve tuaja, dhe t'i përfshini ato në Deklaratat Tatimore që lidhen me Numrin Tuaj Fiskal, në vend se të plotësoni Deklarata të veçanta Tatimore për secilin biznes. Bashkimi i të gjitha të ardhurave, do të ketë ndikim edhe në detyrimet e juaja për TVSH-në, në Deklaratat e juaja Tatimore Vjetore, në Kërkesat për Mbajtjen e Regjistrimeve, si dhe në çdo procedurë tjetër tatimore.

- **Nëse nuk keni aplikuar për Numër Fiskal dhe nëse nuk keni pranuar ndonjë nga letrat më lartë, apo nuk jeni regjistruar në ATK, ju përkujtojmë se jeni të obliguar që sa më parë të lajmëroheni në ATK për të filluar/vazhduar veprimtarinë tuaj ekonomike.**

Ju përkujtojmë se, mos shfrytëzimi i Numrit Fiskal është shkelje, dhe nëse ju nuk e përdorni pas datës 1 Tetor, ATK-ja, do të vendos ndëshkimet e parapara me legjislacionin.

Nëse keni ndonjë pyetje lidhur me këtë ndryshim, ju lutem vizitoni zyrën e juaj lokale të ATK-së.

Ju faleminderit, që paguani tatimet dhe që ndihmoni në zhvillimin ekonomik të shtetit tonë!

Me respekt,
Administrata Tatimore e Kosovës
Shtator 2010